



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e LjUBLANËS), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1236

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “ARHIKO .ING” SH.P.K., si dhe OE “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”, më 06/02/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohen, si te pabazuara ankesat e “ARHIKO .ING” SH.P.K., me nr. 2024/1236, e datës 19/12/2024, si dhe ankesa e OE “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K. me nr.2024/1241 e datës 19/12/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët”, me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E PRISHTINËS”.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “KOMUNA E PRISHTINËS”, për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët”, me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.05.2024, “KOMUNA E PRISHTINËS”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1. Ndërsa me datën 29.11.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës, GOE N.N.SH “Vizion Project”; “SEED CONSULTING” SH.P.K- Prishtinë.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim, Vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00€.

Me 03.12.2024, OE "ARHIKO .ING" SH.P.K dhe OE "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K.me datën 04.12.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 09.12.2024, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE "ARHIKO .ING" SH.P.K dhe me datën 09.12.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K.

Me 19.12.2024, OSHP ka pranuar ankesat nga OE "ARHIKO .ING" SH.P.K me nr. 2024/1236 dhe ankesën e OE "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. me nr.2024/1241 me datën 19.12.2024 lidhur me aktivitetin "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me numër të prokurimit 616-23-4727-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 1236/24 dhe ankesa nr. 1241/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ARHIKO .ING" SH.P.K janë parashtruar si ne vijim:

Për shkak se AK- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Ne mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT).

Ne mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontrate Operatorin Ekonomik të pa përshtatshëm dhe të pa përgjegjshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura ne Njoftim për kontrate (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT)

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES me datën 29.11.2024 ka bere publikimin e Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, ne mënyrë të kundërligjshme na ka eliminuar.

Kjo procedure e tenderimit fillon me pa drejtësi me datën 11.07.2023- ku në këtë njoftim është shpallur fituese kompania 3D-Project, ku dhe kemi parashtruar kërkesën e 1 për rishqyrtim, ku kjo kërkesë na është aprovuar me datën 24.07.2023. Pasi që ka pasur edhe palë të tjera të interesit, procedura ka vazhduar në OSHP nga kompani tjera, ndërsa na është kërkuar edhe vazhdimi i validitetit të tenderit gjatë kësaj periudhe ndërsa çdo validitet është vazhduar sipas kërkesave.

Me datën 15.01.2024 na është kërkuar sqarim saj përket inxhinierëve tanë ndërsa me datën 17.01.2024 ne e kemi ofruar edhe sqarimin sipas kërkesës së AK. Ndërsa me datën 26.01.2024, kemi pranuar edhe sqarimin saj përket çmimeve jo-normalisht të ulëta, ndërsa kemi dërguar edhe sqarimin me datën 29.01.2024, kurse pas këtij sqarimi ne jemi shpallur të papërgjegjshëm, ndërsa nuk jemi eliminuar për çmime mirëpo ne vendimin e datës 29.11.2024, AK ka pretenduar se llogaritja e çmimeve nuk ka qene ne rregull, e që ne rastin konkret kjo gjë nuk qëndron pasi që çmimet tona janë ne rregull dhe nuk ka

ndryshime siç ka pretenduar. Gjithashtu gjatë kësaj kohe ne kemi pranuar kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit ku dhe i kemi vazhduar sipas kërkesave të AK.

Me datën 01.03.2024- kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e 2 të AK, ku në këtë vendim u shpall fituese kompania Florije Jahaj B.I, ku dhe me datën 05.03.2024, kemi dërguar kërkesën tonë të 2 për rishqyrtim ku dhe me datën 11.03.2024, kemi pranuar vendimin ku na është aprovuar kërkesa për rishqyrtim.

Lënda nga ana e operatorit ekonomik Geo-Group ka vazhduar në OSHP, pasi që edhe kompania në fjalë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, kërkesë e cila nuk është aprovuar ndërsa me datën 10.06.2024 është pranuar edhe vendimi i Panelit Shqyrtues, Gjithashtu gjatë kësaj kohe ne kemi pranuar kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit ku dhe i kemi vazhduar sipas kërkesave të AK.

Ndërsa që nga data 18.04.2024- nuk kemi pranuar asnjë kërkesë nga ana e AK për vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe validitetit të ofertës.

Me datën 29.11.2024 kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues ku në këtë vendim AK kundërligjshëm ka vazhduar procedurën e tenderimit, dhe ka eliminuar kompaninë tonë me pretendimin që nuk kemi vazhduar validitetin e sigurimit dhe ofertës, ndërsa që nga data 18.04.2024, një kërkesë të tillë AK nuk e ka parashtruar. AK ka për detyrë që në bazë të nenit.

30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, Autoriteti Kontraktues do të kërkoj nga Operatorët Ekonomik të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. 5/4 Autoriteti Kontraktues do të verifikojë që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit.

AK në mënyrë të qëllimshme ka pasur vonesa në marrjen e vendimit, vonesa të cilat janë të pa justifikueshme pasi ka shkaktuar vonesa duke mos marrë vendimin si dhe ka shkaktuar vonesa në kryerjen e detyrave, ku AK nuk ka dhënë asnjë arsytim se çfarë e ka shkaktuar vonesën në vlerësimin e ofertave dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.1 dhe 40.3 të rregullores 001/2022, ku kjo dispozitë ligjore përcakton që:

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nga komisioni vlerësues, dhe nxjerrja e Njoftimit mbi vendimin e AK nga ZPP, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Ndërsa që nga data 10.06.2024 kur është marrë vendimi i panelit shqyrtues deri me datën 29.11.2024 kanë kaluar 5-muaj e 2-javë e 6-ditë apo 173ditë, kohë e cila është e pa justifikueshme për vonesat.

Ndërsa autoriteti kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ka vazhduar procedurën duke e shpallur fituese një Operatorë ekonomik i cili është dashur që të eliminohet

Ne Certifikatat e biznesit Seed Consulting ka skaduar afati i emërtimit të administratorit: Yll Gjoni i cili ka bërë edhe nënshkrimin e deklaratës nën betim dhe dokumentet tjera në lidhje me këtë procedurë gjatë vlerësimit të ofertave dhe si dokument i tillë nuk është kërkuar gjatë procesit të vlerësimit

Krijimi i grupit nënkupton se secila kompani individualisht janë përgjegjës për kërkesat e Përshtatshmërisë(kërkesat sipas nenit 65-të të LPP-së) dhe bashkërisht janë përgjegjës për kërkesat tjera kualifikuese. Në rastin konkret në dokumentet e Pranueshmëria të Operatorëve Ekonomik- OE- Vision Projekt , ka prezantuar një vërtetim nga ana e Administratës Tatimore me datën 25.11.2024 ku shihet që kjo kompani është në marrëveshje për shlyerjen e borxheve tatimore të mbetura, pasi që nuk ka prezantuar një marrëveshje para ATK-së para publikimit të njoftimit të kontratës ku autoriteti kontraktues

është dashur që të eliminohet nga procedura. Sipas LPP-së dhe RRPP-së si dhe sipas interpretimit të KRPP-së, çdo herë kur dorëzohet një vërtetim i tillë me borxhe dhe në marrëveshje me ATK-në, duhet dorëzohet edhe marrëveshja që OE posedon me ATK-në e cila duhet të posedoj datën më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë e tenderit në fjalë. Ky OE nuk e ka paraqitur këtë kontratë dhe për këtë AK është dashur ta cilësoj si të papërgjegjshëm.

Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronarit të kompanisë Vision Projekt, Sh.Osmanaj është një dokument i cili nuk mund të verifikohet përmes sistemit e-Kosova.

Vërtetimi i kompanisë për shlyerjen e detyrimeve, të kompanisë SEED Consulting, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.

Vërtetimi i Gjyqësor i kompanisë, të kompanisë SEED Consulting, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.

Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronarit të kompanisë SEED Consulting Ylli Gjoni, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.

Nuk është prezantuar Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronareve dhe ortakëve të këtij biznesi të kompanisë SEED Consulting të cilët edhe gjenden edhe të regjistruar në Dokumentet ligjore.- Alban Efthimi, Andi Efthimi, Altin Premti, Olsi Efthimi, Zurich Investment Group.

Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për për Inxhinierin Konstruktiv-Ylli Gjoni(menaxher i projektit)-nuk është prezantuar nostifikimi i diplomës Nostikimi i diplomes ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e njodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet.

Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinierin Elektrikes- Gjergj Dishnica është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform,Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet si dhe profili në cilin ka diplomuar inxhinieri nuk është sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Ndërsa Inxhinieri i Energjetikes. Petrit Kastrati, nuk përmbush përvojën 5vjeqare sipas kërkesës së dosjes së tenderit si dhe njoftimit për kontratë.

Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinierën e Infrastruktures -Marsela Kocellari nuk është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet.

Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinierin Gjeodezisë- Aurel Xhumbi është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet si dhe licensën të cilën e ka prezantuar nuk është sipas kërkesës pasi që licensa nuk është e lëshuar nga Republika e Kosovës.

Inxhinieri konstruktiv-Sedat Ahmeti i prezantuar ne cilësinë e inxhinierit te ndërtimtarisë Konstruktiv, mungon diploma e përkthyer ne një rën nga gjuhët zyrtare te vendit tone në bazë të nenit 13-të LPP-së, përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik.

Në cilësinë e inxhinierit të VNM-së Islam Fejza është licencë e cila ka skaduar me 12.08.2024, ku kjo licencë është pa afat ndërsa gjatë fazës së vlerësimit është dashur të kërkohet. - Ndërsa gjithashtu nuk janë prezantuar vazhdimet e validitetit të kalibrimit të pajisjeve gjeodezike dhe nuk është kërkuar asnjë informatë shtesë para marrjes së vendimit.

Në vazhdimet e validitetit te ofertës së kompanisë së shpallur fituese shihet qartas që ky validitet nuk është në rregull pasi që: Vazhdimi i bërë i datë 17.10.2023- me numër të policës 048980-Në Scardian Sigurime vazhdimi figuron të jetë nga data: 20.11.2023-18.04.2024.

Ku shihet qartas që në vazhdime ka gabime pasi që periudha prej 19.04.2024-21.04.2024- nuk është e përfshirë në asnjërin nga vazhdimet e sigurimeve andaj si të tillë ofertën është dashur që të eliminohet. Vazhdimi i bërë i datë 22.04.2024- me numër të policës-060010860039969-Në Sigal Uniqa Group Austria vazhdimi figuron të jetë nga data: 22.04.2024-22.09.2024

Vazhdimi i bërë i datë 20.09.2024- me numër të policës-060010860040491-Në Sigal Uniqa Group Austria vazhdimi figuron të jetë nga data: 22.09.2024-22.02.2025.

Ku shihet që nga operatori ekonomik në fjalë nuk ka përmbushur sigurinë e tenderit, konfrom nenit 57-të LPP-së-Sigurimi i tenderit.

Me vendimin dhe sqarimet e dhëna nga ana jonë shihet qartas që Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohet sqarim si dhe në të njëjtën kohë edhe pse e kanë ditur që inxhinieri i elektroteknikës është i angazhuar në Komunë nuk kanë eliminuar kompaninë në fjalë pasi që dihet qartas që ky është një konflikt interesit.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në përgjigjen që kemi pranuar pas kërkesës sonë për rishqyrtim-3- kemi sqaruar që pretendimet e Autoritetit Kontraktues për eliminimin tonë nuk qëndrojnë mirëpo për të gjitha pretendimet që kemi sqaruar në mënyrë të detajizuar nuk kemi pranuar fare përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa qartas Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer asnjë përgjigje për këto pika në kërkesën tonë për rishqyrtim ku për këtë pikë Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, më konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet tona ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qartë se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në pikën 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Ndërsa në piken 2 thuhet :Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pra ne kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “ARHIKO .ING” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 57, 59, 60, 64, 65, 66, 68, 69 të LPP-së si dhe Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik-Neni 40-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve- 40.3 Sipas udhëzimit administrativ (MASHT) Nr 12-2018 parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Neni 3-Parimet e përgjithshme për njohje dhe barasvlere Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK qe ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore qe janë në fuqi lidhur me këtë lloj të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr: VENDIM si e bazuar APROVOHET kërkesa e Operatorit Ekonomik : “ARHIKO.ING” SH.P.K në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët me nr. të prokurimit: 616-23-4727-2-1-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES të ANULOHEM njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi I Komunës së Prishtinës në lidhje me aktivitetin e prokurimit: Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët me nr. të prokurimit: 616-23 4727-2-1-1 dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të kërkohej vazhdimet e validitetit të ofertave konform ligjit, në të kundërtën jemi të obliguar që të parashtrijmë Ankesë konform ligjit brenda afateve ligjore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “ARHIKO .ING” SH.P.K janë si vijon:

- Ndërsa qe nga data 18.U4.ZUZ4- nuk kemi pranuar asnjë kërkesë nga ana e AK për vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe validitetit të ofertës.

- Me datën 29.11.2024 kemi pranuar vendimin e Autoritetit Kontraktues ku në këtë vendim AK kundërligjshëm ka vazhduar procedurën e tenderimit. dhe ka eliminuar kompaninë tonë me pretendimin që nuk kemi vazhduar validitetin e sigurimit dhe ofertës, ndërsa që nga data

Parashtruesi po ashtu pretendon se edhe tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

- Juve në ofertën e juaj, tek përshkrimi i çmimeve dhe paramasës shumëmat e nenpozicioneve nuk përputhen me shumëmat totale në pozicione si në vijim:

Shuma e nenpozicioneve A1 deri A5 të pozicionit A në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit A (shuma e nen pozicioneve është 0.22 euro ndërsa për pozicionin A është ofertuar me 0.21 euro). Shuma e nen pozicioneve D1 deri D9 të pozicionit D në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit D (shuma e nenpozicioneve është 0.35 euro ndërsa për pozicionin D është ofertuar me 0.33 euro). Shuma e nenpozicioneve E1 deri E6 të pozicionit E në paramasë nuk përputhen me shumën

totale të vendosur për pozicionit E (shuma e nenpozicioneve është 0.06 euro ndërsa për pozicionin E është ofertuar me 0.08 euro). Shuma e nenpozicioneve F1 deri F5 të pozicionit F në paramasë nuk përputhen me shumën totale të vendosur për pozicionit F (shuma e nenpozicioneve është 0.05 euro ndërsa për pozicionin F është ofertuar me 0.04 euro).

Ju si GOE-ik nuk keni vazhduar sigurimin e tenderit konform kërkesave të FDT-se neni (13 2) data 17.09.2024

Fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk i konteston fare arsyet eliminuese lidhur me paramasën. Po ashtu nuk kundërshton faktin që mungon sigurimi i tenderit. Pra nuk është aspak kontestues që oferta e parashtruesi është e papërgjegjshme. Rrjedhimisht parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me pretendimin e tij drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar pasi që nuk mund të dëshmojë asnjë interes material në rast të rivlerësimit përkitazi me këtë pretendim. Megjithatë AK konfirmon se oferta e tenderuesit të rekomanduar është oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit dhe të gjitha të gjeturat e komisionit vlerësues janë të sakta në tërësi. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Arhiko-ing Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. për ankesën me nr.2024/1241 janë parashtruar si në vijim:

Gjatë vlerësimit të Ofertës tonë ka vepruar në kundërshtim me NENI 7 të LPP-së (BARAZIA NË TRAJTIM/JO DISKRIMINIMI)

Më datën 11.07.2023 – Autoriteti Kontraktues me Vendim dhe shpërblen me Kontratës Kompaninë 3D PROJEKT me çmimin 0.08€ dhe nuk e përfillë NENI 4 bazuar në rregullat për tenderët jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II, dhe III

Pas vendimit të OSHP-së : 2023/0544 të , Lënda është Kthyer në Ri-vlerësim.

Më datën 01.03.2024 – Autoriteti Kontraktues me Vendim dhe shpërblen me Kontratës Kompaninë FLORIE JAHAJ B.I me çmimin 0.47€ dhe nuk e përfillë NENI 4 bazuar në rregullat për tenderat jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II, dhe III

Pas vendimit të OSHP: 2024/0241 , Lënda është Kthyer në Ri-vlerësim.

Më datën 01.03.2024 – Autoriteti Kontraktues me Vendim dhe shpërblen me Kontratës Kompaninë N.SH VISION PROJECT me çmimin 1.59 € dhe nuk e përfillë NENI 4 bazuar në rregullat për tenderët jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II,dhe III

KONKLUZION

Bazuar në provat bashkangjitura Autoritet Kontraktues ka bërë veprime diskriminuese dhe trajtim jo të barabartë mes operatorëve, Gjatë procedurave të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të Ofertave disa aplikon ligjin e ofertave jo-normalisht të ultë konform NENI 7 dhe Formularit B57 i shpërblen me kontratës ndërsa nëse si ofertues të përgjegjshëm me çmim më të lirë e aplikon ligjin për çmim jo-normalisht të ultë me këtë rast AK ka shkelur NENI 7 (Barazinë trajtim /Jo diskriminimi) , paragrafi 1,2 3 dhe 4.

PRETENDIMI ANKIMORË 2:

AUTORITETI KONTRAKTUES NUK E KA RESPEKTUAR TË PARIMET E PËRGJITHSHME EKONOMICITETIN DHE EFIKASITETIN DUKE SHPËRBLIYER ME KONTRATË OPERATORI EKONOMIK ME QMIMINË MË TË SHTRËJTË EDHE OE I REKOMANDUAR PËR KONTRATË KONFORM FORMULARIT B57 DHE NENI4 I PLOTËSON KUSHTET E QMIMI JO-NORMALISHT TË ULTË, NUK JANË SIGURUAR FONDET DHE BURIMET PUBLIKE NË MËNYRË EKONOMIKE , PASI KA SHPËRBLIYER ME KONTRATË O.E ME OFERTËN ME TË SHTRËJTË

NË KUSHTE BARABARTA.

PRETENDIMI ANKIMORË 3

Bazuar në sqarimin të ofertës tonë lidhur me çmimin jo-normalisht e ultë të datës 31.04.2024 : Kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar kemi shpjeguar Ekonominë e Procesit , listën e pagave të angazhuar në këtë projekt , zgjidhjen teknike për inplemetin të kësaj kontrate , koston operative , koston e shpenzimeve në printime si dhe taksat ,tatimet dhe fitimet e përcaktuar me ligjet në fuqi të Kosovës :

Po ja bashkëngjisim dokumentin e ngarkuar :

KONLKUZION

NË KUADËR SQARIMIT TË ÇMIMIT JO-NORMALISHT TË ULTË, NE KEMI MARRË NË KONSIDERAT : EKONOMINË E PROCESIT, PAGAT E PUNËTORËVE , METODOLOGJINË E PUNËS , SHPENZIMET OPERATIVE , TASKA DHE FITIMET TË PËRCAKTUAR ME LIGJ REPUBLIKËS KOSOVË

SIPAS FORMULARIT B57 NENI 4 , PARAGRAFIT 4.4.1 DERI NË 4.6.1 , PASI ANJË KOMPANI KONKURUSESE NUK KA MUNDUR TI JAP SQARIMET MË TË DETAJUARA SI NE DHE KONSIDEROJMË QË SQARIMI ËSHTË I MJAFTUESHËM ËSHTË DASHUR TË NA TRAJTOJ AOTORITETI KONTRAKTUES SIKURSE TENDERËT TJERË , PAS OPERATORËT TJERË I KA SHPËRBLIYER ME KONTRATË PA SQARIM TË PA MJAFTUESHËM.

PROVË

PRETENDIMI ANKIMORË 4:

Më datën 06.03.2024 Miratohet pjesërisht kërkesa për Rishqyrtim dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim:

Pas shqyrtim te dokumentacionit me te cilin kemi Kërkuar qasje kemi Konstatuar QE përgjigja e OE te rekomanduar për Kontrate nuk i ka sqaruar apo zbërthyer te gjitha Pjesët relevante te tenderit SI PSH.

1. PAGAT E STAFIT TE ANGAZHUAR NE KETE PROJEKT
2. KOSTON E SHPENZIMEEVE TE PRNTIMEVE TE PROJEKTIT
3. KOSTON E TATIMEVE DHE BENEFITIT
4. KONSTON E SHPENZIMEVE OPERATIVE

NE KRAHASIM ME SQARIM TONE TE DATES QDO ELEMENT TE DETAJUAR TE DOSJES TENDERIT ; DUKE FILLUAR PREJ PAGES MENAXHERIT KONTRATES , PAGAT E INXHINIERVE TE ANGAZHUAR NE KETET , PROJEKT , KOSTOT E PRINIMEVE , KOSTOT E LIDHJESV E, KOSTOT E SHPENZIMEVE OPERATIVE (DERIVATE , SHPENZIME TELEFONIT) , KOSTON E TATIMEVE , TAKSAVE DHE TVESH , KOSTON E BENEFITIT TE PLANIFIKUAR , PO ASHTU KEMI KERKUAR QE SIGURIMIN E EZEKUTIMIT TENDERIT TA RRISIM NGA 10% NE 30% ,

KUR DZ OPERATIRE ME KUSHTE BARABARTA ME QMIM JO-NORMALISHT TE ULTE VLEN GJITHMON OFERTA ME QMIMIN ME TE LIRE , PASI PARIM BAZE I LIGJIT PROKURIMIT (SI SHTYLL THEMELORE) ESHTË SHFRYTEZIMI I FONDVE PUBLIKE NE MENYRE RACIONALE.

Vendimi i datës 29.11.2024 , ËSHTË VENDIM KONTRADITORË I KOMISIONIT VLERËSIMIT PASI JEMI ELEMNUAR PËR NJË PRETENDIM TË CILIN E KEMI SAQUAR “ QMIMI JO-NORMALISHT I ULT ” DHE I NJËJTI ËSHTË MIRATUAR ME DATËN 06.03.2024 DHE

KONSIDEROJMË QË KY PRETENDIM ËSHTË I GJYKUAR, REST -JURIDIKATA .

ME RASTIN KONKRET AUTORITETIT KONTRAKTUES KA VEPRUAR N MËNYRË KUNDËR THËNËSE PASI ME DATËN 29.11.2024 E MIRATON SI TË BAZUAR PRETENDIMET OE ANKUES STUDIO HAPSIRA SHPK SI TË BAZUAR, NDËRSA ME DATËN 29.11.2024 PËR TË NJËJTA PRETENDIME NA ELEMIONON.

Me rastin konkret AK ka vepruar në kundërshtim me NENI 7 (Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi) paragrafi 6

PRETENDIMI ANKIMORË 5:

GOE rekomanduar për kontratë VISION PROJEKT&SEED CONSULTING ME VLERË TË PESHUAR 1.59 Euro ,bazuar në rregullat për tenderët jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II, dhe III

1. Ka ofruar çmim më shumë se 30% se çmim mesatar i tenderëve të përgjegjshëm
2. Ka ofruar çmim më shumë se 10% se çmim ose kostot e tenderit të dytë më të ultë
3. Janë Dorëzuar të paktën 3 tenderë.

KONLUZION :

KOMISIONI VLERËSIMIT KA VEPRUAR NË KUNDËRSHTIM NE NENI 4 TË KËSAJ RREGULLORA PARAGRAFI 4.1 DHE 4.2 OFERTËN E GRUPIT OPERATORËVE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË NUK E TRAJTUAR OFERTËN E TI PËR QMIM JO-NORMALISHT TË ULTË

AUTORITETI KONTRAKTUES E KA SHKELUR KËTË NENI GJATË PROCEDURAVE VLERËSIMIT.

PROVË :

Në sqarimin zyrtarë përmes emailit zyrtarë të datës : 12.12.2024 nga zyra prokurimit e pranon që OE i rekomanduar për kontratë nuk i kanë kërkuar kërkesë për sqarimin e çmimi jo normalisht të ultë për sqarimin e tenderit jo-normalisht të ultë edhe pse i plotëson të 3 kriteret e çmimit jo normalisht të ultë konform formularit B57.

Me rastin konkret AK ka vepruar në kundërshtim me NENI 7 (Barazia në Trajtim/Jo diskriminimi) paragrafi 3 dhe 6

NE RASTIN KONKRET OE KA SHKELUR NENI 7 (NENI 7 : Barazia në trajtim / jo- diskriminimi)

AUTORITETI KONSTRAKTUES NA KA DISKRIMINUAR DUKE NA ELEMIONUAR PËR TENDERIN JO NORMALISHT TË ULTË , NDËRSA KA REKOMANDUAR PËR KONTRATË NJË KOMPANI E CILA PO ASHTU E KA TENDERIN JO NORMALISHT TË ULTË PA KËRKUAR EDHE SQARIMIN PËR QMIM JO NORMALISHT TË ULTË ,KONFORM RREGULLA PËR QMIM JO NORMALISHT TË ULTË neni 3 , PARAGRAFI 3.1,3.2,3.3 DHE NENI 4 PARAGRAFI 4.1 DHE 4.2

PROVË

NE DOKUMENTET E ÇASJE TENDERIT SHIFET QARTË QË MUNGON FORMULARI I SQARIMIT TENDERIT PËR ÇMIMIN JO NORMALISHT PËR GRUPIN E OPERATORËVE TË

REKOMANDUAR PËR KONTRATË.

PRETENDIMI ANKIMORË 4 :

NË VENDIMIN E OSHP-së , Tenderim jo-normalisht i ultë nuk ka qenë subjekt i trajtimi dhe gjykimit , nuk e kuptoj si kanë mundur ta aktualizoj Autoriteti Kontraktues një pretendim të cilën e ka miratuar vetë dhe e njëjta nuk ka qenë subjekt i gjykimit dhe vendimit OSHP-së

Ne jemi eliminuar për çmimin jo normalisht të ultë në vendimin e datës 01.03.2024 , kemi bërë rishqyrtim kundër këtij vendim me datë 06.03.2024 ku miratohet sqarimi i çmimi jo-normalisht të ultë, në mënyrë kontradiktore eliminohem për të njëjtin pretendim i cili paraprakisht ishte aprovuar dhe nuk ka qenë subjekt i vendimit OSHP- për tu rivlerësuar.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 56, 59, 66, 67, 69 dhe 72 të LPP-së si dhe RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë) NENI 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve . Kërkojmë që të anulohet vendimi i dhënies dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim në të kundërtën jemi obliguar që lëndë ta dërgojmë në OSHP.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K. Pretendimet e OE "Studio Hapësira" janë se "Bazuar në sqarimin të ofertës tonë lidhur me çmim jo-normalisht e ultë të datës 31.04.2024 : Kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar kemi shpjeguar Ekonominë e Procesit, listën e pagave të angazhuar në këtë projekt, zgjidhjen teknike për inplemetin të kësaj kontrate, koston operative, koston e shpenzimeve ne printime si dhe taksat ,tatimet dhe fitimet e përcaktuar me ligjet në fuqi të Kosovës. GOE rekomanduar për kontratë VISION PROJEKT&SEED CONSULTING ME VLERË TË PESHUAR 1.59 Euro ,bazuar në rregullat për tenderët jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për qmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II, dhe III".

Arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi sipas letrës standarde të bashkangjitur me njoftimin mbi vendimin janë si vijon:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye : ? Autoriteti kontraktues ju ka dërguar letrën standarde B41 kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët. Pas analizimit të sqarimeve tuaja, Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se sqarimet e dërguara nuk janë bindëse sepse çmimet për projektim janë abnormalisht të ulëta. Çmimi abnormalisht i ulët është kalkuluar mbështetur në rregulloren për Prokurim Publik 001/2022, neni 41

Sa i përket pretendimit se parashtruesi nuk ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët duke kundërshtuar konstatimin e komisionit vlerësues, fillimisht duhet cekur se nga 8 ofertat e dorëzuara, komisioni vlerësues ka gjetur se ekziston vetëm një ofertë me çmim më të lirë sesa parashtruesi me 0.08 euro ndërsa çmimi i parashtruesit është i dyti më lirë me 0.23 euro. Të gjitha çmimet tjera janë rreth 0.40 euro e më lartë (pra janë 2 fish apo 3 fish më të shtrenjta sesa çmimi i parashtruesit). Për këtë arsye komisioni vlerësues ka kërkuar sqarim shtesë nga parashtruesi i cili ka kthyer përgjigje me datë 31.01.2024.

Sqarimet e tilla janë analizuar me kujdes nga komisioni vlerësues në kuptim të nenit 41.8 dhe 41.9 të RRPP ku përcaktohet se "41.8 Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

- a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
- c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. 41.9Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:

a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet".

Me këtë rast komisioni ka konfirmuar pa asnjë mëdyshje se çmimi i ofertuar është jonormalisht i ulët pasi që në sqarim fare nuk janë argumentuar: "- ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

- çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

-çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

-origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

-elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet".

Sa i përket pretendimit ankimor se edhe oferta e tenderuesit të rekomanduar është jonormalisht e ulët, së pari duhet sqaruar se ky pretendim është kundërtëhënës me pretendimin paraprak sepse oferta e tenderuesit të rekomanduar është 1,59 euro ndërsa oferta e parashtruesit është 0.23 euro. Pra nuk ka kuptim të pretendohet se çmimi prej 0.23 euro nuk është jonormalisht i ulët ndërsa çmimi prej 1.59 është i tillë. Sidoqoftë, AK ka analizuar me kujdes ofertën e tenderuesit të rekomanduar dhe ka gjetur se oferta në fjalë është e vetmja e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Përmes nenit 4.3 të RRPP përcaktohet se "Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë". Në rastin konkret nuk janë përmbushur këto kritere dhe nuk ekziston asnjë dilemë për çmim jonormalisht të ulët nga tenderuesi i rekomanduar. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Studio Hapsira Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 23/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1236/24 dhe me datën 23/12/2024 ankesën me nr. 1241/24, ndërsa me datë 10.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1236 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe pretendimet ankimore të lartcekura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues Arhiko.ING SH.P.K , është e PABAZUAR,

Të mbetet ne fuqi NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-së, i datës 29.11.2024

Ndërsa për ankesën 2024/1241 me datën 10.01.2025 rekomandimi si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe pretendimet ankimore të lartcekura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues: - Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues Studio Hapsira SH.P.K, është e PABAZUAR, -Të mbetet ne fuqi NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-së, i datës 29.11.2024

Raportin e ekspertizës me nr.1236/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të

ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.1241/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “ARHIKO .ING” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1236 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim: Ky aktivitet i prokurimit i iniciuar nga Komuna e Prishtinës është për here te tretë ne ankesë ne OSHP.

OE Geo - Group shpk i cili ka parashtruar ankesë herën e parë dhe te dytë kësaj radhe nuk ka parashtruar ankesë.

Ne Vendimin e P.SH N.r 2024/0241 te datës 10.06.2024 specifikohet:

"Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Geo– Group SH.P.K.&Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K” te aprovohet si e pjesërisht e bazuar. Lënda të ri-vlerësohet konform neneve 59 dhe 60 të LPP, jo për shkak të kësaj ankesë por pasi që edhe ashtu vendimi për dhënie i AK është anuluar nga vet AK, në bazë të aprovimit të disa kërkesave tjera për ri shqyrtim, me çast edhe ashtu lëndën e ka kthyer në ri-vlerësim."

OE Arhiko.ING SH.P.K dy herat e kaluar nuk ka parashtruar ankesë, pra i njëjti ankesë pranë OSHP-se ka parashtruar vetëm me 19.12.2024.

Përgjigje ne pretendimet ankimore te OE Arhiko.ING SH.P.K

Ne fillim te ankesës OE ka bere një kronologji te këtij aktiviteti ku ka specifikuar te gjitha vendimet, kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat pran OSHP-se.

Pasi qe OE ankues nuk i ka ndare pretendimet ankimore ne vijim eksperti shqyrtues jap mendimet ne pretendimet e cekura

OE ankues pretendon se anëtari i GOE te rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshme sepse Ne Certifikatat e biznesit Seed Consulting ka skaduar afati i emërimit të administratorit: Yll Gjoni i cili ka bërë edhe nënshkrimin e deklaratës nën betim dhe dokumentet tjera në lidhje me këtë procedurë gjatë vlerësimit të ofertave dhe si dokument i tille nuk është kërkuar gjatë procesit të vlerësimit

Zyra e prokurimit me datën 15.01.2024 ka dërguar tek OE ne fjale Letrën standarde - kërkesën për sqarim, ndërsa me datën 17.01.2024 OE ka kthyer përgjigje ne kërkesën për sqarim.

Ne përgjigjen e dhënë nga OE ne fjale shihet se pika e pare ka qene rreth z. Yll Gjoni ku OE sqaron se:

Ne baze te sqarimit te OE shihet se ka ndryshime tek biznesi SEED Consulting sh.p.k, ku i njëjti ka bashkangjitur edhe dokumentet përkatëse sa i perkete këtyre ndryshimeve.

Verifikimin e këtyre te dhënave eksperti shqyrtues ka bere edhe përmes webfaqes se Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) (qkb.gov.al) ku shihet saktë se te dhënat e deklaruar nga OE ne sqarimet e datës 17.01.2024 janë te sakta.

Nga sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues konstaton se sa i perkete kësaj pjese te pretendimit gjate fazës se vlerësimit te këtij aktivitetit është sqaruar qeshtja ne fjale Nga përshkrimi i mësipërm dhe konstatohet se kjo pjese e këtij pretendimi ankimor është e pa bazuar.

Pjese tjetër e pretendimit ankimore është se:

OE- Vision Projekt , ka prezantuar një vërtetim nga ana e Administratës Tatimore me datën 25.11.2024 ku shihet që kjo kompani është në marrëveshje për shlyerjen e borxheve tatimore të mbetura, pasi që nuk ka prezantuar një marrëveshje para ATK-së para publikimit të njoftimit të kontratës ku autoriteti kontraktues është dashur që të eliminohet nga procedura. Sipas LPP-së dhe RRPP-së si dhe sipas interpretimit të KRPP-së, çdo herë kur dorëzohet një vërtetim i tillë me borxhe dhe në marrëveshje me ATK-në, duhet dorëzohet edhe marrëveshja që OE posedon me ATK-në e cila duhet të posedoj datën më të hershme se sa data e njoftimit për kontratë e tenderit në fjalë. Ky OE nuk e ka paraqitur këtë kontratë dhe për këtë AK është dashur ta cilësoj si të papërgjegjshëm.

Ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nga ana e Autoritetit Kontraktues tek Kërkesat e përshtatshmërisë është kërkuar:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Sipas kërkesës se zyrës se prokurimit peran autoritetit kontraktues OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar dokumentet e kërkuara dhe një nder këto dokumente është edhe Vërtetimi i lëshuar nga ATK për OE Vizion Project (Shkëlqim Osmani B.I.) i lëshuar me date 25.11.2024 ne te cilin vërtetim specifikohet se "Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura."

Dokumenti/Vërtetimi ne fjale është verifikuar edhe ne webfaqen e ATK-se ku shihet se është i njëjte me atë te dorëzuara nga ana e OE.

Eksperti shqyrtues mendon se dokumenti ne fjale është dorëzuar sipas kërkesës se AK-se dhe brenda afateve kohore ashtu siç është kërkuar specifikuar ne Dosjen e tenderit. Andaj ne baze te dëshmimeve te prezantuara dhe kërkesës se AK-se eksperti shqyrtues mendon se kjo pjese e pretendimit ankimor është e pa bazuar.

OE ankues pretendon se: Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronarit të kompanisë Vision Projekt, Sh.Osmanaj është një dokument i cili nuk mund të verifikohet përmes sistemit e-Kosova.

Ne baze te dëshmimeve shihet se Dokumenti ne fjale është dorëzuar dhe i njëjti shihet se është gjeneruar nga sistemi elektronik nuk mund te vërehet se ka ndonjë ndërhyrje, megjithatë nëse OE dyshon për origjinaliteti e dokumentit ne fjale dhe dokumenteve tjera mund ti drejtohet organeve kompetente. Eksperti shqyrtues sqaron se edhe kjo pjese e këtij pretendimi është e pabazuar

OE ankues pretendon se sa i perkete dokumenteve te pranueshmerise te Anëtarit tjetër te konzorciumit:

- Vërtetimi i kompanisë për shlyerjen e detyrimeve, të kompanisë SEED Consulting, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.
- Vërtetimi i Gjyqësor i kompanisë, të kompanisë SEED Consulting, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.
- Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronarit të kompanisë SEED Consulting Ylli Gjoni, është një vërtetim i cili nuk mund të verifikohet në mënyrë automatike.

Ne këto pretendime OE nuk ofron asnjë dëshmi apo agrumet se dokumentet ne fjale nuk janë ne përputhje me kërkesat dhe se te njëjtat si dokumente nuk përmbushin kërkesat e AK-se por vetëm i specifikon se te njëjtat nuk mund te verifikohen ne mënyrë elektronike, andaj ne baze kësaj eksperti shqyrtues sqaron se kjo pjese e pretendimit ankimor nuk është e bazuar

Ne ankesën e ti OE Ankues vazhdon me pretendimet se GOE te rekomanduar për kontrate për anëtarin e konzorciumit SEED Consulting shpk se:

Nuk është prezantuar Vërtetimi i certifikatës mbi dënimet penale të pronareve dhe ortakëve të këtij biznesi të kompanisë SEED Consulting të cilët edhe gjenden edhe të regjistruar në Dokumentet ligjore.- Alban Efthimi, Andi Efthimi, Altin Premti, Olsi Efthimi, Zurich Investment Group.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne lidhje me këtë pretendim OE i rekomanduar për kontrate ne sqarimet e dërguara me 17.01.2024 ka sqaruar se sa i perkete Anëtarit te Konzorciumit SEED Consulting shpk 100% pronar është Yll Gjoni dhe për këtë ka bashkangjitur dokumentin EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR” GJENDJA E REGJISTRIMIT i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) (qkb.gov.al) ne te cilin dokument evidentohet saktë se i vetmi pronar është z, Yll Gjoni, te njëjti dokument vërtetohet lehtë edhe ne webfaqen e këtij institucioni. Eksperti shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar

Sipas ankesës OE pretendon se:

- Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për për Inxhinierin Konstruktiv-Ylli Gjoni(menaxher i projektit)-nuk është prezantuar nostifikimi i diplomës Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet.
- Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinierin Elektrikes- Gjergj Dishnica është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomes ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet si dhe profili në cilin ka diplomuar inxhinieri nuk është sipas kërkesës së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.
- Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinieren e Infrastruktures-Marsela Kocellari nuk është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e ndodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet.

-Në dokumentacionin ku kishim qasje ne kemi parë që për Inxhinierin Gjeodezisë- Aurel Xhumbi është prezantuar nostifikimi i diplomës -Nostikimi i diplomës ne Kosove sipas kërkesës së AK, dhe konform,Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.12/2018 parimet dhe procedurat e njodhjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës e që në rastin konkret mos përmbushja e kërkesave sipas ligjit të fuqi është dashur që të eliminohet si dhe licensën të cilën e ka prezantuar nuk është sipas kërkesës pasi që licenca nuk është e lëshuar nga Republika e Kosovës.

Sa i përket kësaj kërkesë ne dosjen e tenderit është kërkuar

Për te gjithë personelin profesional CV-te, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Licenca për gjeodetin, Licenca nga MMPH për ekspertin e vlerësimit te ndikimit ne mjedis , Licenca e ekspertit për punimin e e laborantit

Ndërsa sipas dokumenteve te cilat gjenden ne sistem për këtë aktivitet shihet se ne kërkesën për sqarim te datës 15.01.2024 AK ka kërkuar sqarime edhe rreth këtyre dokumenteve siç pretendon OE ankues.

Ndërsa me datën 17.01.2024 OE i rekomanduar për kontrate ka kthyer përgjigje ku nder te tjera e ka sqaruar se:

Andaj ne baze te kërkesë se dosjes se tenderit sqarimeve te ofruara nga OE i rekomanduar per kontrate dhe ne mbështetje te Ligjit NR.08/L-216 për RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR NJOHEJEN E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË BALLKANIN PERENDIMOR eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Njeherit OE ankues pretendon se:

Ndërsa Inxhinieri i Energjetikes. Petrit Kastrati, nuk përmbush përvojën 5vjeqare sipas kërkesës së dosjes së tenderit si dhe njoftimit për kontratë.

Sa i perkete Inxhinieri i Energjetikes ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është kërkuar

Një (1) Inxhinier i diplomuar (5 vite) ose master i Elektros (drejtimi Elektro energjetik (Projektues) min. 5 vite përvojë

Sipas dokumenteve te prezantuara nga OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar dy ingjiner te Energjetikes, përveç z, Kastrati ka dorëzuar dokumentet edhe per z. Gjergj Dishnica

Ne baze te dëshmime te prezantuara z. Dishnica e plotëson përvojën e kërkuar prej 5 viteve andaj edhe pretendim ankimor është i pabazuar.

Ne ankese OE ankues e specifikon edhe pretendimin se

Inxhinieri konstruktiv-Sedat Ahmeti i prezantuar ne cilesin e inxhinierit te ndërtimtarisë- Konstruktiv, mungon diploma e përkthyer ne njëren nga gjuhet zyrtare te vendit tone në bazë të nenit 13-të LPP-së, përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

Ne baze te dokumenteve te prezantuara diploma e inxhinierit Sedat Ahemi eshte ne gjuhen serbe dhe e njëjta ka kaluar proceduarat e njohjes se diplomës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe VNDIMI I lëshuar nga MASHT është ne gjuhen shqipe. Ne ketë dokument tregohet se z.Sedat Ahmeti me gradën Inxhinier I Diplomuar I Ndërtimtarisë ka mbaruar studimet katër vjeçare me gjithsej 240 ECTS. Sipas sqarimeve te specifikuara me larte për mendiumin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është i pa bazuar

OE Ankues përveç tjerash ne ankese pretendon se:

Në cilësinë e inxhinierit të VNM së Islam Fejza është licencë e cila ka skaduar me 12.08.2024, ku kjo licensë është pa afat ndërsa gjatë fazës së vlerësimit është dashur të kërkohet

Siç shihet ne dosje e OE ne momentin e dorëzimit te dokumenteve dokumenti ne fjale ka qene me afat dhe i njëjti ka përmbushur kushtet sipas dosjes se tenderit.

Pike tjetër e ankesës është edhe se:

Ndërsa gjithashtu nuk janë prezantuar vazhdimet e validitetit të kalibrimit të pajisjeve gjeodezike dhe nuk është kërkuar asnjë informatë shtesë para marrjes së vendimit.

Ne baze te dëshmive te prezantuara për pajisjet gjeodezike shihet se te njëjtat kane qene te kalibruara brenda vitit ne momentin e dorëzimit te tenderit.

Pike tjetër e ankesës se OE ne fjale është edhe ajo se:

Në vazhdimet e validitetit te ofertës së kompanisë së shpallur fituese shihet qartas që ky validitet nuk është në rregull pasi që: Vazhdimi i bërë i datë 17.10.2023- me numër të policës 048980-Në Scardian Sigurime vazhdimi figuron të jetë nga data: 20.11.2023-18.04.2024.

Ku shihet qartas që në vazhdime ka gabime pasi që periudha prej 19.04.2024-21.04.2024- nuk është e përfshirë në asnjërin nga vazhdimet e sigurimeve andaj si të tillë ofertën është dashur që të eliminohet. Vazhdimi i bërë i datë 22.04.2024- me numër të policës-060010860039969-Në Sigal Uniqa Group Austria vazhdimi figuron të jetë nga data: 22.04.2024-22.09.2024

Sa i perekte kesa pike eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te dokumenteve te prezantuara ne sistemin e prokurimit elektronik shihet se me 18.04.2024 ne ora 17:46 përmes sistemit elektronik ka dërguar tek OE kërkesën për Vlefshmërinë e Sigurimit te Tenderit.

Ne dokumetin ne fjale specifikohet se "Afati i fundit për dorëzim e vlefshmërisë se sigurimit të tenderit është (22.04.2024) ora 16:00

Ne baze te dokumenteve shihet se OE ne fjale me datën 22.04.2024 ora 15:26 ka ngarkuar ne sistem Sigurimin e tenderit siç është kërkuar nga ana e AK-se, ne këtë sigurim specifikohet se është valid nga data 20.04.2024 deri me 22.09.2024

Ne baze te sqarimeve te lartpërmendura dokumenteve te cilat gjenden ne sistemin e prokurimit dhe dëshmive te prezantuara nga OE shihet saktë se OE ne fjale Sigurimin e tenderit e ka dorëzuar brenda afatit te lejuar nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe se i njëjti i përmban te gjitha pikat qe kërkohet me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate andaj edhe kjo pike e këtij pretendimi ankimore për mendimin e ekspertit shqyrtues është e pa bazuar

Pjese e pretendimeve ankimore është cekur se:

Me vendimin dhe sqarimet e dhëna nga ana jonë shihet qartas që Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit ka bërë shkeljen e deklaratës nën betim Sipas Neneve 1,11 dhe 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 duke mos zbatuar detyrën për të cilën edhe e ka nënshkruar këtë deklaratë duke eliminuar kompaninë tonë për kritere të kanë mundur të kërkohet sqarim si dhe në të njëjtën kohë edhe pse e kanë ditur qe inxhinieri i elektroteknikes është i angazhuar ne Komune nuk kanë eliminuar kompaninë në fjalë pasi që dihet qartas që ky është një konflikt interesit.

Tek kjo pike OE ankues nuk ka qene i qarte dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi apo argument se ndonjëri nga inxhinieret e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate është staf i Komunës se Prishtinës andaj

për mendimin e ekspertit kjo pike e pretendimit ankimore është e pabazuar

Përveç tjerash OE ankues pretendon se:

Në përgjigjen që kemi pranuar pas kërkesës sonë për rishqyrtim-3- kemi sqaruar që pretendimet e Autoritetit Kontraktues për eliminimin tonë nuk qëndrojnë mirëpo për të gjitha pretendimet që kemi sqaruar në mënyrë të detajzuar nuk kemi pranuar fare përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktues, ndërsa qartas Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer asnjë përgjigje për këto pika në kërkesën tonë për rishqyrtim ku për këtë pikë Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP, më konkretisht nenin 108/A, duke mos u përgjigjur dhe arsyetuar përgjigjet në pretendimet tona ankimore, i njëjti ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP, me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

OE ankues pretendon se ka dorëzuar ofertën në përputhje të plote me kërkesat e dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 59 të LPP-se specifikohet se kur konsiderohet një tender i përgjegjshme saktësisht në pikën 4 të nenit 59 thuhet se: " Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Ndërsa në nenin 40.6 të RREGULLORE NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK sqarohet në detaje se kur një tender konsiderohet i përgjegjshëm

40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Në bazë të dokumenteve të bashkangjitura në ofertën e GOE ankues shihet qarte se ka mospërputhje të çmimeve tek kolona Çmimi i peshuar ashtu siç edhe i ka specifikuar Autoriteti Kontraktues në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 29.11.2024 po ashtu në të gjitha dokumentet që janë të sistemit të prokurimit elektronik për këtë aktivitet nuk mund të shihet askund se OE ankues ka sqaruar Ofertën financiare.

Se ka mospërputhje të çmimeve në disa tabela tek OE ankues mund të shihet shumë lehtë dhe atë tabelat A HARTIMI I PROJEKTEVE GJEODEZIKE, Tabela D HARTIMI I PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS RRUGORE, Tabela E HARTIMI I PROJEKTEVE TË STRUKTURAVE BETONARME DHE TJERA, dhe tek Tabela F HARTIMI I PROJEKTEVE TJERA

Se këto mospërputhje janë evidente në këto tabela po e elaborojmë njëri nga to dhe atë Pozicioni E më konkretisht pozicionet nga E1 deri në E6 i kanë 6 pozicione dhe për të njëjtat OE ankues ka ofruar me çmim nga 0.01 për çdo pozicion ndërsa shumë e tyre duhet të jete 0.06 euro, ndërsa OE ankues ka ofertuar Shumen 0.08 për të gjitha këto pozicione.

Nga të gjitha sqarimet e dhëna më lartë eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike në e-prokurim, rrjedhjen dhe procedurën e prokurimit me këtë aktivitet të prokurimit është në përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që vlerësimi, ekzaminimi dhe

krahasimi i ofertave te behën ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se si dhe legjislacionit sekondare te prokurimit. Gjatë vlerësimit të gjithë OE pjesëmarrës te trajtohen ne mënyrë te barabartë dhe te respektohen kërkesat e përzgjedhjes te cilat janë te vendosura nga ana e Autoriteti kontraktues, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe te gjitha Anekset dhe kërkesat e specifikuara ne dosjen e tenderit si dhe te respektohen ne përpikëri kriteret e dhënies.

Lidhur me pretendimet e OE "STUDIO HAPSIRA" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1241 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim: Ky aktivitet i prokurimit i iniciar nga Komuna e Prishtinës është për here te trete ne ankesën OSHP.

Herën e pare dhe te dyte ankese pranë OSH-se ka parashtruar OE Geo-Group shpk

Ne Vendimin e P.SH Nr. 2024/0241 te dates 10.06.2024 specifikohet:

"Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Geo-Group SH.P.K. & Ilyrian Consulting Engineers SH.P.K" te aprovet si pjesërisht e bazuar. Lënda të ri-vlerësohet konform neneve 59 dhe 60 të LPP, jo për shkak të kësaj ankese por pasi që edhe ashtu vendimi për dhënie i AK është anuluar nga vet AK, në bazë të aprovimit të disa kërkesave tjera për ri shqyrtim, me çrast edhe ashtu lëndën e ka kthyer në ri-vlerësim."

GOE STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK nuk ka parashtruar ankese pran OSHP-së ne dy rastet e me hershme, ankesën e ka dorëzuar kësaj radhe me date 19.12.2024.

Përgjigje ne pretendimet ankimore te GOE STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK

Përgjigje në pretendimin ankimor 1. Sipas pretendimit ankimor Nr. 1 operatori ekonomik ankues pretendon se:

Autoritet Kontraktues ka bërë veprime diskriminuese dhe trajtim jo të barabartë mes operatorëve, Gjatë procedurave të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të Ofertave disa aplikon ligjin e ofertave jo-normalisht të ultë konform NENI 7 dhe Formularit B57 i shpërblen me kontratës ndërsa nëse si ofertues të përgjegjshëm me çmim më të lirë e aplikon ligjin për çmim jo-normalisht të ultë me këtë rast AK ka shkelur NENI 7 (Barazinë trajtim /Jo diskriminimi) , paragrafi 1,2 3 dhe 4.

Ne lidhje me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues me datën 26.01.2024 ju ka dërguar Letrën Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët gjithë 6 nga 8 OE pjesëmarrës ne ketë aktivitet te prokurimit.

Sipas dokumenteve te cilat gjenden ne sistemin e prokurimit për këtë aktivitet GOE qe kane ofruar me çmimin me te larte nga data 20.11.2023 nuk e kane vazhduar sigurimin e tenderit andaj te njëjtit janë eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Te 6 OE kane kthyer përgjigje ne Letrën Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët.

Nga sqarimet e cekura me larte shihet se Autoriteti Kontraktues gjate vlerësimit te këtj aktiviteti ka respektuar nenin 7 Barazinë trajtim /Jo diskriminimi pasi qe ju ka kërkuar sqarim për tender jo-normalisht të ulët 6 OE pjesëmarrës. Për mendimin eksperti shqyrtues pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 2. Sipas pretendimit ankimor Nr. 2 operatori ekonomik ankues pretendon se:

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar te parimet e përgjithshme ekonomicitetin dhe efikasitetin duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik me çmimin me të shtrenjtë edhe OE I rekomanduar për kontratë konform formularit B57 dhe neni 4 I plotëson kushtet e çmimit jo-normalisht te ulët, nuk janë siguruar fondet dhe burimet publike ne mënyrë ekonomike, pasi ka shpërblyer me kontrate O.E me oferten me te shtrenjtë ne kushte te barabarta.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne këtë pretendim ankimor OE ankues specifikon ne njerën ane se specifikon se nuk janë respektuar parimet e përgjithshme Eonomiciteti dhe Efikasiteti ku është rekomanduar për kontrate OE me çmimin me te shtrenjte po ashtu specifikon se AK e ka shpërblyer me kontrate OE i plotëson kushtet për tu shpallur si tender jo normalisht i ulet si dhe nuk janë siguruar fondet dhe burimet publike ne mënyre ekonomike.

Ne baze te kërkesës për mendimin e eksperti shqyrtues OE ne këtë pretendim është I pa qartë pasi qe dikon e specifikon se OE I rekomanduar për kontrate plotëson kushtet për tender jo-normalisht te ulet por qe nuk ka prezantuar asnjë fakt apo dëshmi ne lidhje me këtë, ndërsa dikund e specifikon se është shpërblyer me kontrate OE me çmimin me te shtrenjtë. pretendimi ankimore për mendimin e ekspertit shqyrtues është i pa bazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 3. Sipas pretendimit ankimor Nr. 3 operatori ekonomik ankues pretendon se:

Bazuar në sqarimin të ofertës tonë lidhur me qimen jo-normalisht e ultë të datës 31.04.2024 : Kemi shpjeguar në mënyrë të detajuar kemi shpjeguar Ekonominë e Procesit , listën e pagave të angazhuar në këtë projekt , zgjidhjen teknike për inplemetin të kësaj kontrate , koston operative , koston e shpenzimeve në printime si dhe taksat ,tatimet dhe fitimet e përcaktuar me ligjet në fuqi të Kosovës

Ne këtë pretendim OE ka bashkangjitur edhe dokumentin e ngarkuar si dhe ka sqaruar se ne kuadër te sqarimit për çmim jo-normalisht te ulet ka marr ne konsiderata: Ekonominë e procesit pagat e punëtoreve, Metodologjinë e punës, Shpenzimet Operative, Taksat dhe fitimet e përcaktuara me ligjet e Republikës se Kosovës sipas formularit B57 nenit 4, paragrafit 4.4.1 deri 4.6.1, pasi asnjë kompani konkurruese nuk ka mundur ti jap sqarimet me te detajuara si dhe konsiderojnë se sqarimi është I mjaftueshëm dhe është dashur qe ti trajtojnë AK si tenderët e tjerë pasi qe OE tjerë I ka shpërblyer me kontrate pa sqarime shtese.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne lidhje me këtë AK ne mbështetje te Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët respektivisht Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK ,ju ka kërkuar sqarime shtese OE me datën 26.01.2024 ndërsa OE me 31.01.2024 ka kthyer sqarimet rreth kërkesës për sqarime.

Sipas nenit 41.6 te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK “Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët”.

Ndërsa ne nenin 41.3 te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK specifikohet saktë se kur “Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ne baze të këtyre specifikave dhe në mbështetje të RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK me poshtë po e prezantojmë analizën për këtë aktivitet

Në çdo rast kur tenderët duken jo normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Nga kjo analize shihet qarte se OE ankues I ka plotësuar të gjitha kushtet për tu trajtuar si tender jo-normalisht I ulët.

Ne sqarimin e datës 31.01.2024 të dërguar nga OE ankues shihet se I njëjti I ka prezantuar shpenzimet e planifikuara për realizimin e këtij projekti ku I ka grupuar në 4 tabela dhe të njëjtat I ka dërguar tek AK.

Ne baze të nenit 40.10 të RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK është në përgjegjësinë e AK-se për të vlerësuar se sqarimet e dërguara a janë të mjaftueshme apo jo.

41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:

a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, “Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët”, brenda dy dite nga data e vendimit. Ne baze të sqarimeve të specifikuara më lartë për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor është i pabazuar

Përgjigje në pretendimin ankimor 4 Sipas pretendimit ankimor Nr. 4 operatori ekonomik ankues pretendon se:

Më datën 06.03.2024 Miratohet pjesërisht kërkesa për Rishqyrtim dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim:

Vendimi i datës 29.11.2024, është vendim kontradiktor i komisionit të vlerësimit pasi jemi eliminuar për një pretendim të cilin e kemi sqaruar “Çmimi jo-normalisht I ulët” dhe njëjti është miratuar me datën 06.03.2024 dhe konsiderojmë që ky pretendim është I gjykuar, REST-JURIDIKATA.

Me rastin konkret Autoriteti Kontraktues ka vepruar në mënyrë kundër thënës pasi me datën 11.03.2024 e miraton si të bazuar pretendimet e OE ankues Studio Hapësira SHPK, ndërsa me datën 29.11.2024 për të njëjtat pretendime na eliminon.

Ne lidhje me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në mbështetje të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit në sistemin elektronik nga ana e AK-se me datën 11.03.2024 ka marr vendim “Miratohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim të OE Studio Hapësira SHPK të datës 06.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024”.

Në këtë vendim specifikohet se aprovohet pjesërisht pretendimi ankimor që ka të bëjë me OE të rekomanduar për kontratë por askund nuk specifikohet se është aprovuar pjesa që ka të bëjë me eliminimin e OE ankues.

Këtë e vërteton edhe vete OE ankues ku në ankese e ka prezantuar komplet pjesën e vendimit që ka të bëjë me trajtimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 06.03.2024. Andaj në baze të sqarimeve të cekura më lartë eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5. Sipas pretendimit ankimor Nr. 5 operatori ekonomik ankues pretendon se:

GOE rekomanduar për kontratë VISION PROJEKT&SEED CONSULTING ME VLERË TË PESHUAR 1.59 Euro ,bazuar në rregullat për tenderët jo normalisht të ultë - Formulari B57 i plotëson të gjitha kushtet për çmim jo-normalisht të ultë Konform NENI 3 (Informatat e përgjithshme) ,paragrafi I ,II, dhe III

1. Ka ofruar çmim më shumë se 30% se çmim mesatar i tenderëve të përgjegjshëm
2. Ka ofruar çmim më shumë se 10% se çmim ose kostot e tenderit të dytë më të ultë
3. Janë Dorëzuar të paktën 3 tenderë.

Ne këtë pretendim ankimor OE ankues ka bashkangjitur edhe nenin 3 dhe 4 te Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Eksperti shqyrtues sqaron se legjislacioni sekondar ku është bazuar OE ne ketë ankese“B57 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët” është shfuqizuar me date 01.11.2022 dhe si i till nuk është ne fuqi nga data e specifikuar me larte.

Ne baze te ofertave te pranuar OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson asnjërin nga kriteret e specifikuar për tu trajtuar si tender jo-normalisht i ulet.

Një analize e tillë është prezantuar dhe elaboruar ne sqarimet e dhëna tek pretendimi ankimor 3.

Eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6.

Sipas pretendimit ankimor Nr. 6 operatori ekonomik ankues pretendon se:

NË VENDIMIN E OSHP-së , Tenderim jo-normalisht i ultë nuk ka qenë subjekt i trajtimi dhe gjykimit , nuk e kuptoj si kanë mundur ta aktualizoj Autoriteti Kontraktues një pretendim të cilën e ka miratuar vetë dhe e njëjta nuk ka qenë subjekt i gjykimit dhe vendimit OSHP-së

Ne jemi eliminuar për çmimin jo normalisht të ultë në vendimin e datës 01.03.2024 , kemi bërë rishqyrtim kundër këtij vendim me datë 06.03.2024 ku miratohet sqarimi i çmimi jo-normalisht të ultë, në mënyrë kontraditore eliminohem për të njëjtin pretendim i cili paraprakisht ishte aprovuar dhe nuk ka qenë subjekt i vendimit OSHP- për tu rivlerësuar.

Kërkojmë që të anulohet vendimi i dhënies dhe lënda të kthehet në Ri-Vlerësim në të kundërtën jemi obliguar që lëndë ta dërgojmë në OSHP.

Ne lidhje me këtë pretendim Eksperti shqyrtues sqaron se I njëjti ne një pjese është përshkruar si ne pretendimin e 4 po dhe ne pretendimet tjera për te cilat janë dhënë sqarimet adekuate.

Ndërsa tek paragrafi I fundit I këtij pretendimi OE ankues ky paragraf ka mbetur nga kërkesa për rishqyrtim.

Ne lidhje me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se është I pabazuar.

Operatori Ekonomik ankues ne pjesën dërmuese te pretendimeve ankimore si baze ligjore e specifikon legjislacionin sekondare gjegjësisht nenet e “B57 Rregullat per Tenderët Jo-Normalisht të Ulët” e cila si e tillë nuk është ne fuqi qe nga data 01.11.2022

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve te dokumentuara ne platformën elektronike ne e-prokurim, rrjedhjen dhe procedurën e prokurimit më këtë aktivitet te prokurimit është ne përgjegjësi dhënë diskrecion te Autoriteti Kontraktues qe vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave te behën ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se si dhe legjislacionit sekondare te prokurimit. Gjatë vlerësimit të gjithë OE pjesëmarrës te trajtohen ne mënyrë te barabartë dhe te respektohen kërkesat e përzgjedhjes te cilat janë te vendosura nga ana e Autoritetit kontraktues, specifikimet teknike Aneksil dhe te gjitha Aneksset dhe kërkesat e specifikuara ne dosjen e tenderit si dhe te respektohen ne përpikëri kriteret e dhënies.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimin të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues ia fal besimin e plotë konstatimeve të raportit të ekspertit shqyrtues i cili këto konstatime i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “ARHIKO .ING” SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PRISHTINËS”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me nr. të prokurimit: 616-23-4727-2-1-1.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër,

Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “STUDIO HAPSIRA” SH.P.K. duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA E PRISHTINËS”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët” me nr. të prokurimit: 616-23-4727-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - ARHIKO .JNG SH.P.K., STUDIO HAPSIRA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: